

RAPORT I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

OBJEKTI " REHABILITIM I PORTIT TE VLORES, LOTI I "

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES

PERMBAJTJA

1. HYRJE

2. KUADRI POLITIK, LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

- 2.1 Politika.
- 2.2 Baza Ligjore.

3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

- 3.1 Pozicioni gjeografik.
- 3.2 Statusi i zones se studiuar dhe objektvi i projektit.
- 3.3 Infrastruktura rrugore e zones dhe rruget ndihmese.

4. TREGUESIT TEKNIKE TE PROJEKTIT DHE KOSTOJA E PROJEKTIT

5. EKONOMIA E ZONES DHE AKTIVITETET KRYESORE TE SAJ

- 5.1 Statusi i zones ne studim.
- 5.2 Variantet e zhvillimit ne perspektve.
- 5.3 Mendimi i komunitetit.
- 5.4 Planet e zhvllhmit urban te zones.
- 5.5 Ekosistemet, habitatet dhe pesazhi egzistues.
- 5.6 Trashegimia arkitektonike dhe historike.

6. METODIKA E VLERESIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

- 6.1 Objektivat dhe qellimi i V.N.M.-se.
- 6.2 Metodika e kryerjes se V.N.M.-se.
- 6.3 Identifikimi i ndikimeve ne mjedis nga zbatmi i projektit.

7. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE DHE VLERESIMI I SITUATES

- 7.1 Ndikimet ne mjedis gjate rehabilitimit te portit.
- 7.2 Ndikimet ne mjedis gjate peregatitjes se strukturave te portit.
- 7.3 Ndikimet ne mjedis gjate largimit te materialeve nga germimet dhe ç'pimet me sonda, etj.
- 7.4 Ndikimet ne mjedis si rezultat i sjelljes se materialeve te ndryshme ne kantier.
- 7.5 Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese.
- 7.6 Zhurmat.
- 7.7 Ndikimet ne det

8. PLANI I ZBUTJES SE NDIKIMEVE NEGATIVE

- 8.1 Perdorimi tokes.
- 8.2 Ndikimi tek njerezit, ndertesat dhe objektet e ndertuara nga njeriu.
- 8.3 Ndikimet e portit mbi trashgimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe vepra te tjera njerezore.
- 8.4 Ulja e intensitetit te erozionit dhe zbutja e ndryshimeve te topografise.

9. NDIKIMET NE FLORE, FAUNE DHE GJEOLOGJINE

- 9.1 Bimet e ujit
- 9.2 Flora dhe Fauna

10. NDIKIMET E PRITSHME NE MJEDISIN PERRETH

- 10.1 Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise se zones, tokes, etj.
- 10.2 Ndikimet e projektit ne modelin drenazhues te zones
- 10.3 Ne cilesine dhe sasine e tokes
- 10.4 Ndikimet ne uje
- 10.5 Ndikimet e ndotesve dhe mbetjeve ne cilesine e ujit
- 10.6 Ndikimet ne ajer
- 10.7 Ndikimi ne klime
- 10.8 Aromat sulmuese
- 10.9 Ndikime te tjera klimatike
- 10.10 Ndikime te tjera indirekte dhe sekondare, qe shoqerojne projektin
- 10.11 Ndikimet shoqeruese te projektit me projekte te tjera ekzistuese e te propozuara

11. MASAT PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

- 11.1 Organizimi
- 11.2 Masat e sigurimit teknik ne pune
- 11.3 Mbrojtja e mjedisit
- 11.4 Masat e mara per zbutjen e rrezikut ne mjedis dhe shendet

12. MATRICAT PERMBLEDHESE TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

- 13.1 Matrica e ndikimeve ne mjedis
- 13.2 Matrica e prioriteteve te ndikimeve ne mjedis gjate fazes se rehabilitimit dhe shfrytezimit

13. ASPEKTET NEGATIVE DHE POZITIVE TE NDIKIMIT NE MJEDIS

- 14.1 Efektet negative
- 14.2 Efektet pozitive

14. PROGRAMI I MONITORIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS TE PROJEKTTI

15.1 Plani i monitorimit

15.2 Programi i monitorimit

15.3 Plani i monitorimit gjate operimit

15. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. HYRJE

Rajoni i Shqipërisë Jug-Perendimore, ku bën pjesë porti Vlores, është hapësirë e rëndësishme e parë nga vlerat turistike dhe mjedisore të vendit të kësaj.

Shqipëria ka nënshkruar dhe është zbatuese e rregullt e një numri Konventash Nderkombëtare (Barcelona, Ramsari, Konventa e Biodiversitetit, etj), dhe tashmë ka një paketë të plotë ligjore për masat mbrojtëse të mjedisit dhe vlerësimit të impaktit ambjental të veprimtarive, shërbimeve apo ndërtimeve në mjedisin veprues.

Ky kuader ligjor dhe angazhimet ndërkombëtare në fushën e mjedisit, shtojnë shumë detyra ndaj institucioneve për të zbatuar një sistem sa më efektiv për administrimin e mjedisit, jo vetëm në drejtim të zgjidhjes së problemit për rritjen e kapaciteteve përpunuese dhe transportuese të portit të Vlores, por dhe zbatimin e përgjegjësive të rrjedhura nga këto marrëveshje. Vendi ynë duke qenë anëtar i një numri konventash, detyrohet të zbatojë një sistem sa më efektiv ekonomik, social-mjedisor, për rregullimin e territorit, sidomos në funksion të zgjidhjes së problemeve të ndryshme mjedisore.

Në zhvillimin ekonomik-shoqëror të një vendi, gjithnjë në përputhje me parimin universal të zhvillimit të qëndrueshëm, marrin rëndësi të vecante gjetja e rrugëve dhe teknologjive më efikase, si për shfrytëzimin sa më racional të pasurive natyrore, ashtu edhe për kontrollin cilësor dhe sasior të ndikimit mbi mjedis, dhe sidomos në ujërat e detare.

Gjatë dekadave të fundit veprimtari të ndryshme kanë ndikuar dukshëm në mjedisin rrethues në përgjithësi, dhe në atë ujor në veçanti. Shkarkimet e ujërave të përdorura urbane dhe industriale në lumenj edete janë tashmë një dukuri e rëndomtë, të cilat në mënyrë progresive kanë ndikuar në demtimin e cilësive së mjedisit në brigjet e detit Adriatik dhe Jon. Këto ndikime shpesh herë të njohura por edhe të panjohura, janë më të dukshme në impaktin që kanë në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin në përgjithësi.

Rehabilitimi i portit sipas standarteve bashkëkohore të një vendi që aderon të bëhet anëtar i BE, është tepër i rëndësishëm për aktivitetin normal të tij. Për këtë qëllim ndërhyrja, me synim rehabilitimin dhe rritjen e kapaciteteve përpunuese të tij, duhet koordinuar me aktivitete të tjera jetësore, turistike dhe ekonomike të zonës.

Vëmendje e veçantë duhet të kete sidomos:

- kur këto porte janë afër qendrave të banuara,
- kur nga këto objekte rrisin punësimin dhe sjellin të ardhura për aktivitetet ekonomike përreth tij,
- kur ka objekte turistike dhe plazhe publike që janë të lidhura me nevojat për higjienë,
- kur zhvillohen aktivitete të akuakultures,
- kur janë zona që kanë një status të vecante, etj.

Prishja e këtyre ekuilibrave vjen si pasojë e një shfrytëzimi pa kriter të këtyre porteve nga anijet që ankorohen në port dhe mund të derdhin mbetjet e tyre (ujërat e përdorura, vajra dhe karburante) në port të cilat shpërndahen dhe dalin në breg ku demtojnë gjallesat dhe përdoruesit e detit. Duhet të theksojmë se porti i Vlores

eshte nje objekt ekzistues dhe ka eksperience te gjate te administrimit te tij dhe gjithashtu rregulla strikte mbi vendepozitimet e mbetjeve te anijeve qe ankorohen.

Ne nenin 4 (kater) te Ligjit Nr. 8990, date 23.1.2003 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" (V.N.M.) eshte dhene ne menyre te qarte se cilat projekte i nenshtrohen vleresimit te ndikimit ne mjedis te cilat klasifikohen si me poshte:

1. Procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis (V.N.M.) i nenshtrohen gjithë projektet e veprimtarite, qe jepen ne shtojcat 1 dhe 2 te ketij ligji, para miratimit tyre nga organet perkatese.
2. Projektet e veprimtarite i nenshtrohen dy niveleve te shqyrtimit per vleresim ndikimi ne mjedis:
 - a) Procesit te thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis nenshtrohen projektet e shtojces 1 dhe projektet e veprimtarise qe kerkojne te zbatohen ne nje zone te mbrojtur.
 - b) Procesit te permbledhur te vleresimit te ndikimit ne mjedis (V.N.M.), te cilit i nenshtrohen projektet e shtojces 2 dhe ndryshimet ose rikonstruksionet e projekteve te shtojces 1.

Ne respektim te percaktimeve ne Ligjin Nr. 8990, date 23.1.2003 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe Udhezimin Nr.6, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie", me investitor Ministria e Transportit dhe Infrastruktures, e cila eshte ne fazen e hartimit te projektit te zbatimit "Rehabilitimi i Portit Vlores, Loti I".

TAB 1. KLASIFIKIMI I RAPORTIT TE VLERESIMIT NE MJEDIS PER PROJEKTIN E "REHABILITIMIT TE PORTIT VLORES"

Pyetje qe duhen marre parasysh per klasifikimin gjate projekt-zbatimit apo ushtrimit te veprimtarise:	Pershkruaj shkurtimisht Po / Jo	Do te kete nderveprim / ndikim te rendesishem? Po / Jo - Perse?
1. Do te shikaktohen ndryshime fizike ne territor (ne topografinë, perdorimin e tokes ose burimet ujore etj.)?	Po (punimet jane per thellimin e portit dhe reabilitim te pontileve dhe skolierave)	Jo (reabilitimi i portit ekzistues nuk ka ndikim te rendesishem ne mjedis pasi po nderhyet per te ritur funksionalitetin e tij sipas standarteve bashkohore)
2. Do te perdoren burimet natyrore si toka, uji, materiale ose energji, vecanerisht ato burime qe nuk jane te rinovueshme ose me pakice?	Po (toka ne breg dhe uji i detit)	Jo (veprat qe rehabilitohen jane ekz. dhe sipërfaqia e detit qe shfrytëzohet nuk ndryshon)
3. Parashikohet perdorimi, magazinimi, transporti apo prodhimi i substancave ose materialeve te demshme per shendetin dhe mjedisin?	Jo	
4. Do te prodhohen mbetje te ngurta?	Po (gjate gërmimit per thellimin e basenit dhe pontileve)	Jo (te gjitha mbetjet e ngurta do te transportohen ne toke, ne nje vend grumbullimi per mbetjet e ngurta)
5. Do te kete shkarkime ne ajer te ndotesve, substancave te rrezikshme, toksike ose helmuese?	Jo	
6. Do te kete zhurma e vibrime apo cilirime drite, energjie ose rrezatim elektromagnetik?	Po (zhurma e vibrime gjate reabilitimit)	Jo (porti eshte ekzistues dhe banesat aty afer nuk kane shfaqur probleme me zhurmat e mjeteve)

		lundruese)
7. Do të ketë rrezik për ndotjen e tokës e ujërave nga shkarkimi i ndotesve në sipërfaqen e tokës, ujërave sipërfaqësore, nëntokësore, bregdetare ose në det?	Po (Gjatë rehabilitimit dhe shfrytëzimit të portit)	Jo (Po të zbatohen dhe respektohen me rigorozitet kushtet e zbatimit të rehabilitimit dhe shfrytëzimit të portit)
8. Ka rrezik për aksidente që ndikojnë në shëndetin e njerezve apo në mjedis?	Po (gjatë rehabilitimit të veprave hidroteknike)	Jo (do të respektohen rregullat e sigurimit teknik)
9. Do të ketë ndikime sociale, demografike, mënyra tradicionale jetese, punësim etj?	Po (hapje vende pune, rritje të fluksit të njerezve që do të qarkullojnë në zone)	Po (impakt pozitiv)
10. Ka faktore të tjera që duhen marrë në konsideratë si zhvillime që çojnë në pasojë mjedisore apo mundësi për mbivendosje ndikimesh të ndryshme nga veprimtari ekzistuese ose të planifikuara në zone?	Jo	
11. Ka zona të mbrojtura nga legjislatiomi nderkombëtar/kombëtar për vlerat e tyre në biodiversitet, ekologji, peizazh, vlera kulturore, historike e arkeologjike?	Jo	
12. Ka zona të ndjeshme mjedisore, si zona bregdetare, male, pyje, kullota, flore, faunë e eger, dru frutore në zone?	Po (zone bregdetare)	Jo (punimet janë brenda portit ekz.)
13. Ka zona me specie të mbrojtura, të rëndësishme ose të ndjeshme, rrezikuara, kërcënuara, në rrezik zhdukjeje të faunës e floras, p.sh. për kryqezime, folelizime, pushime, dimerime, migrime etj. në zone?	Jo	
14. Ka zona me ujëra tokësore, nëntokësore apo detare në zone?	Po (Zona detare)	Jo (nuk ka ndikim të rëndësishëm)
15. Ka zona me tipare të spikatura panoramike ose skenike në zone?	Po (Bregu i detit)	Jo (nuk ka ndikim të rëndësishëm)
16. Ka rrugë a infrastruktura të ngjashme që përdoren nga publiku për të shkuar në vende pushimi etj. ose rrugë transporti të mbingarkuara që mund të ndikohen?	Po (Rruga nacionale e bregdetit të rivierës së Jugut)	Jo (nuk ka ndikim të rëndësishëm)
17. Ka përdorime ekzistuese të tokës (banime, industri, tregti, pushim, bujqësi, pyje, turizëm, zona të gjelbra, sportive, argetuese, prona të tjera private etj.) ose plane të ardhshme që ndikohen?	Po (porti ekzistues, industria që lidhet me të dhe turizmi)	Po (ka ndikim të rëndësishëm)
18. Është zona nën rrezikun e ndotjes ose dëmtimeve mjedisore ku standartet mjedisore janë tejkaluar?	Jo	
19. Është zona me probleme sa i përket termeteve, rreshqitjes së dherave, erozionit, përmytjeve, kushteve ekstreme klimatike (ndryshime të temperaturës, mjegulla erera të forta)?	Jo	

2. KUADRI POLITIK, LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

2.1 Baza Ligjore

Ndergjegjsimi në Shqipëri është i një niveli të ulët, kjo si rrjedhojë e një legjislativi mjedisor relativisht të ri që është në zhvillim dhe po plotësohet me tej sidomos me rregullore dhe standarte.

Aplikimet per V.M.M. kane si detyrim paketen ligjore te meposhteme:

- Ligji Nr. 8934, dt 05.09.2002 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”,
- Ligji Nr. 8990, dt. 23.01.2003 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”,
- Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.249, dt 24.04.2003 “Per Miratimin e Dokumentacionit per Leje Mjedisore dhe te Elementeve te Lejes Mjedisore”.
- Udhezues metodik i Ministrise se Mjedisit, Tirane, “Per Pergatitjen e Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”
- Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 805, date 04.12.2003 “Per Miratimin e Listes se Veprimtarive qe Ndikojne ne Mjedis per te cilat kerkohet Leje Mjedisore”.
- Urdherin e Ministrit Nr. 137, date 17.08.2004. “Per Dokumentacionin e Domosdoshem per te kerkuar Leje Mjedisore”, etj.
- Udhezimin Nr.6, date 27.12.2006 “Per miratimin e metodologjise vleresimit paraparak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie”
- Ligj Nr.10431, Datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen E Mjedisit”
- Ligj Nr.10440, Datë 7.7. 2011 “për Vlerësimin E Ndikimit Në Mjedis”
- Ligji Nr. 111/2012, date 03.12.2012 “Për Menaxhimin E Integruar Të Burimeve Ujore”.

Raporti i Vleresimit Ndikimit ne Mjedis perfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimit te projektit ne mjedisin fizik. Ky proces zhvillohet brenda atij te planifikimit dhe zbatimit te projektit, duke paraqitur prioritetet mjedisore dhe listen e veprimeve per zgjidhjen e tyre. Raporti realizon bashkepunimin midis pushtetit vendor, pushtetit qendror dhe biznesit, duke i paraprire zhvillimit te sigurte dhe te qendrueshem.

Ne vijim jane pershkruar vecorite kryesore te projektit te cilat, se bashku me investigimet ne vendin e rehabilitimit te parashikuar per ushrimin e aktivitetit, kane sherbyer per identifikimin e ndikimeve ne mjedis, te rehabilitimit te portit te Vlores objekt i ketij vleresimi.

3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

3.1 Pozicioni gjeografik

Porti i Vlorës ndodhet ne koordinata gjeografike 40°27 N 19°29 E ndodhet në Jug Perendim të Shqipërisë në Detin Adriatik është porti i dytë i Shqipërisë i radhitur pas portit të Durrësit për sa i takon madhësisë dhe kapacitetit. Është porti më i madh i jugut dhe u shërben të gjitha qendrave jugore të Shqipërisë dhe në shumë raste dhe ngarkesave tranzit në thellesi të Ballkanit, Kosovës, Maqedonis etj...

Shoqëria e Portit Detar Vlore ushtron aktivitetin e tij ekonomik administrativ si shoqëri aksionere me pronar të vetëm shtetin. Porti i Vlorës është ndërtuar në gjirin e Vlorës dhe ka një sipërfaqe totale prej 5.3ha, me akuarium 5 ha. Është një port i hapur me 2 kalata kryesore ku përpunohen anije tregtare dhe tragete. Jashtë sistemit

të koordinatave në radë mund të sigurohet një ankorim i sigurt dhe një vend që i mbron anijet falë vetë pozicionit gjeografik që ka Gjiri i Vlorës. Nuk ka rryma uji, as batica as zbatica të forta që mund të ndikojnë lundrimin.

Porti i Vlorës e shtrin aktivitetin e vet përpunues në 2 kalata:

-Kalata Lindore

-Kalata Perëndimore

Në Kalatën Lindore përpunohen vetëm anije tregtare, ajo ka një gjatësi 339m dhe mund të përpunohen anije me peshë deri në 6.000 Ton dhe thellësi 10.5m. Në Kalatën Perëndimore deri para disa vitesh përpunoheshin anijet tregtare dhe tragete ku ishin të instaluar dhe 2 vinxha portual me kapacitet 5ton secili. Sot funksionin vetëm si kalatë për tragetet. Ajo ka një gjatësi 322 m ku mund të përpunohen 3 tragete. Në këtë kalatë mund të kryet dhe furnizimi me uje i anijeve.

Futja në përdorim e terminalit të ri të pasagjerëve ndertuar në vitin 2002 ka krijuar komoditet dhe një vizion të ri në përpunimin e trageteve. Porti i Vlorës ka në dispozicion të klientëve sheshe dhe magazina për deponimin tranzit, të cilat jepen me qera në dispozicion të një përpunimi sa më të efektshëm për shkarkimin e mallrave. Magazina të mbyllura janë 2.100m², sheshe deponimi janë 9.000m².

Nisur nga nevoja gjithmonë e në rritje për një port me përmasa dhe infrastrukturë bashkëkohore edhe Porti i Vlorës ka një plan zhvillimi, ndërtimi, prespektv mbeshetur në investime të shtetit Shqiptar dhe atij Italian kanë nënshkruar një marrëveshje financiare.

Përmirësimi total i infrastrukturës parashikon zgjerimin dhe rikonstruksionin e kalatave si dhe ndërtimin e terminalit të trageteve e cila ka qënë dhe faza e parë e investimeve dhe që do të vazhdoj më tej me investime më të fuqishme. Faza e dytë e zhvillimit është zgjerimi dhe ndertimi i barrierave mbrojtëse, për të bërë Portin e Vlorës të manovrueshëm në çfarë do lloj kohe. E gjithë kjo për ta bërë portin e Vlorës një qendër të madhe transporti, mallrash dhe pasagjerësh në brendësi të Shqipërisë dhe Ballkanit.

3.2 Statusi i zones se studiuar dhe objektivi i projektit

Porti i Vlores ndodhet ne qytetin e Vlores dhe perdoret per transportin e mallrave dhe pasagjereve. Porti ndodhet ne zone turistike dhe te banuar gjate gjithe vitit. Projekti i rehabilitimit te portit, parashikon te shfrytëzoje siperfaqen ekz. dhe te risi kapacitetet perpunuese duke ritur numrin e anijeve dhe trageteve qe do te hyjne ne te. Eshte parashikuar thellimi i basenit te portit. Përmirësimi total i infrastrukturës parashikon zgjerimin e kalatave si dhe rehabilitimin e terminalit të trageteve e cila ka qënë. Faza e dytë e zhvillimit është zgjerimi dhe ndertimi i barrierave mbrojtëse, për të bërë Portin e Vlorës të manovrueshëm në çfarë do lloj kohe. E gjithë kjo për ta bërë portin e Vlorës një qendër të madhe transporti, mallrash dhe pasagjerësh në brendësi të Shqipërisë dhe Ballkanit.

3.3 Infrastruktura rrugore e zones dhe rruget ndihmese

Zona pershkohet nga rruga nacionale Sarande-Vlore-Tirane. Ndertimi i portit ne afersi te kesaj rruge lehteson ndjeshem punimet ndertimore dhe shfrytezimit e tij. Pavaresisht nga kjo per fazen e rehabilitimit dhe shfrytezimit jane parashikuar rikonstruksioni dhe mirembajtja e rrugeve ndihmese. Rruget e sherbimit per shpimet gjeologjike dhe ndertimet e reja te kalatave jane pjese perberese e punimeve civile dhe kosto e rehabilitimit eshte perfshire ne kostot totale te punimeve civile.

4. TREGUESIT TEKNIKE TE PROJEKTIT

Karakteristikat baze te Portit te Vlores jane paraqitur me poshte:

Eshte planifikuar germimi i shtratit te detit brenda basenit te portit deri ne njeh thellësi -7.50 m nen nivelin mesatar te ujit.

Germimi i shtratit te detit ne thellësi deri ne -7.50 m nen nivelin mesatar te detit krijon nje siperfaqe te barabartë me rreth 32.900 m² ne menyre te tille qe te kryhet ne te njejten kohe perpunimi i 4 mjeteve lundruese sipas kapaciteteve te projektuara.

Strukturat e bankinave janë parashikuara te tilla qe ne te ardhmen te shkojne deri ne -8.50 m nen nivelin mesatar te ujit per zgjerimin kapacitetit te portit ne fazat e metejshme.

Sistemimi dhe asfaltimi i rrugeve te portit jane ne njeh siperfaqe totale prej rreth 40.435m².


Nga thellimi i portit arrihet nje brez lundrimi ne kuoten e projektit nga bankina deri ne hyrje te portit me distance 200 m (shih figurën më poshtë).

Vëllimi i germimit sipas projektit te zbatimit eshte rreth 144.000m³.

Mbas zbatimit te projektit do te jete nje vend per manovrimin e anijeve me njeh diametër prej 250m.

Ne kete faze do te ndertohen pontilet per ankorimin e anijeve me lartesi +2.30 m mbi nivelin mesatar te ujit.

Gjatesia e skolierave eshte 470 ml ku do te behet perpunimi i anijeve dhe trageteve.



5. EKONOMIA E ZONES DHE AKTIVITETET KRYESORE TE SAJ

5.1 Statusi i zones ne studim

Ne zone, historikisht dhe tradicionalisht, gje qe vazhdon edhe sot, ka gjetur zhvillim bujqesia, blektoria tregetia, turizmi dhe peshkimi, por kohet e fundit nje vend te rendesishem po merr dhe sektori i sherbimeve, pasi zona shquhet per vlerat dhe potencialet e saj turistike. Nga aktivitetet e mesiperme popullsia mbulon 70-75% te nevojave ekonomike.

5.2 Variantet e zhvillimit ne perspektive

Liberalizimi i vizave me zonen Shengen dhe shtimi i kerkesave per levizje te lire me shtetet fqinje, kerkon te behet i mundur shfrytëzimi me eficiencë i kapaciteteve, per te punuar me ngarkese mesatare dhe ne pik, për

plotesimin e nevojave dhe si rrjedhim do te kete nje impakt pozitiv duke lehtesuar komunikimin e njerezve dhe mallrave. Mbeshtetur ne investimin qe do te realizohet do te kemi nje shtim te kapaciteteve perpunuese te portit.

5.3 Mendimi i Komunitetit

Per zhvillimin e ketij projekti investitori, Ministria e Transportit dhe Infrastruktures i ka kushtuar nje vemendje te vecante bashkepunimit me pushtetin vendor. Qe ne fillimin e studimeve per kete projekt, eshte marre kontakt me drejtuesit lokal ku shtrihet objekti, duke i kerkuar miratimin ne parim te projektit per rehabilitimin e tij.

5.4 Planet e zhvillimit urban te zones

Zhvillimi i kesaj hapsire parashtron disa kerkesa dhe kushte rigoroze ndaj vendim marresve. Projekti i rehabilitimit te portit gjithmone duke minimizuar efektet negative ne pejsazhin e bregdetit, do te kontribuojte ne uljen e kohes se perpunimit te anijeve te mallrave dhe transportit te pasagjereve me traget, me cilesi te larte.

5.5 Ekosistemet, habitatet dhe peisazhi egzistues

Zona e kerkuar per rehabilitimin e portit ka nje pejsazh terheqes te bregdetit e kombinuar me nje zone malore me aktivitet kryesisht turizem sezonal, banim, bujqesor, blegtoral dhe te aktiviteteve te ndryshme ekonomike.

5.6 Trashegimia arkitektonike dhe historike

Gjate hapjes se trasese nuk mundet te takohen objekte dhe trashegimi qe bartin vlere kulturore.

6. METODIKA E VLERESIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte bazuar ne projektin e zbatimit qe parashikon rehabilitimin e portit ekzistues. Qellimi i hartimit te raportit te vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte marrja parasysht e faktoreve qe ndikojne ne mjedis gjate rehabilitimit te objektit dhe funksionimit te tij.

Ky raport eshte pjesa me e rendesishme e dokumentacionit te kerkuar, ne zbatim te procedures se nevojshme gjate procesit te miratimit te lejes mjedisore. Raporti ka gjithashtu si qellim te jape nje veshtrim te pergjithshem mbi efektet ne mjedis, alternativat e mundshme dhe masat zbutese te efekteve te padeshirueshme.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis (V.N.M.) eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultonin nga nje projekt zbatimi gjate zbatimit ashtu dhe gjate funksionimit te tij. V.N.M.-ja perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit nepermjet:

- Marrja ne konsiderate e ceshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit te zbatimit.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimit cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt, etj.

Qellimi i këtij Raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (V.N.M.), i përgatitur për rastin e Rehabilitimit të Portit të Vlores, është që të identifikojë pasojat e mundshme negative mjedisore që mund të krijohen gjatë rehabilitimit dhe shfrytëzimit të tij.

Gjithashtu një tjetër synim i këtij Raporti të V.N.M.-se është të përcaktojë e të rekomandojë masat tekniko-organizative për zbutjen e faktoreve negative që ekzistojnë, dhe të atyre që krijohen gjatë rehabilitimit dhe shfrytëzimit të tij. V.N.M.-ja e këtij projekti është hartuar për të integruar mbrotjen ambientale në jetën e përditshme, që të udhëheqë në ndryshimin e sjelljes së komunitetit, duke u bërë në këto mënyra forca shtytëse e përmirësimit të vazhdueshëm. Metoda më e përshtatshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis është ajo e listës së kontrollit, e cila vendos nga njëra anë të gjitha burimet e mundshme të ndikimeve, dhe nga ana tjetër mbartësit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhësisë së ndikimit.

6.1 Objektivat dhe qëllimi i V.N.M.-se

Objektivat e V.N.M.-se konsistojnë në analizimin e faktoreve lokale negative të mjedisit, në dhënien e masave zbutëse për reduktimin e tyre. Qëllimi i V.N.M.-se është, që nëpërmjet vlerësimit cilësor e sasior paraprak të parametërve hidroteknike të treguesve gjeologjiko-inxhinjerie, parametërve sizmo-tektonike, morfologjike e gjeomorfologjike të bazuara në kritere e standarte shkencore ndërkombëtare, të tipizohen dhe të përzgjidhen një sërë parametrash dhe vecorish të sistemeve të sipërpermendur natyrore, në shërbim të infrastrukturës mjedisore, të infrastrukturës urbane si dhe shfrytëzimit të portit, etj.

Ky raport ka për qëllim të shërbejë:

- Si instrument për mbrotjen e mjedisit;
- Në fuqizimin e komunitetit për veprime në mbrotje të mjedisit;
- Në kontrollin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Në rritjen e mirëqenies nga menaxhimi afatgjatë i burimeve ujore;
- Në mbrotje të pasojave financiare dhe social-ekonomike;
- Në rritje të interesimit për bashkëpunim dhe në gjetjen e zgjidhjeve të reja, etj.

6.2 Metodika e kryerjes së V.N.M.-se

Studimi vlerësimit të ndikimit në mjedis u orjentua;

- nga rëndësia e rehabilitimit dhe shfrytëzimit të portit, sipas standarteve bashkëkohore,
- nga përmbushja e kërkesave vendase dhe të huaja,
- nga vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore e humane të zonës si dhe vlerave të vecanta të tyre,
- në identifikimin e ndikimeve negative dhe lokale,
- marrjen e masave zbutëse, duke patur parasysh ruajtjen e interesave ekonomike të investimit,
- në masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm etj.

Në këtë raport identifikohen ndikimet lokale negative në mjedisin humane, si dhe është marrë parasysh vlerësimi i rrezikut. Reduktimi i ndikimeve negative, është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme lokale dhe strukturore në fazat kryesore:

- Hartimi i objektivave orientuese te raportit te V.N.M.-se;
- Mbledhja e materialit baze ekzistues dhe plotesimi i formularit perkates per kete raport, si dhe seleksionimit te tyre per perdorim.
- Verifikimi ne terren i te dhenave ekzistuese, mbledhja e te dhenave biofizike dhe humane;
- Hartimi i V.N.M.-se dhe dorezimi tek porositesit Ministria e Transportit dhe Infrastruktures si dhe ne subjektet vendimarrese dhe kontrolluese te aspekteve mjedisore ne nivel lokal dhe qendror.

6.3 Identifikimi i ndikimeve ne mjedis nga zbatimi i projektit

Nga vleresmi i veçorive kryesore te projektit, dhe me investigimet ne zonen e parashikuar per rehabilitimin e portit te Vlores eshte bere identifikimi dhe vleresimi i ndikimeve te mundeshme ne mjedis nga ndertimi i ketij porti. Ne perputhje me Udhezimin Nr.6, date 27.12.2006 "Per miratimin e metodologjise se vleresimit paraprak te ndikimit ne mjedis te nje veprimtarie" me keto identifikime dhe vleresime eshte plotesuar tabela I e Aneksit II te ketij udhezimi per te analizuar ne menyre te detajuar vleresimet sasiore te ndikimeve ne mjedis nga zbatimi i projektit te rehabilitimit te portit te Vlores:

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TE "REHABILITIMIT TE PORTIT VLORES"

Nr	Pyetje qe konsiderohen ne fazen e perzgjedhjes	Po/ Jo	Cilet elemente te mjedisit mund te ndikojne/ si?	Do te jete ndikimi domethenes ne mjedis? Pse?
I. A do te perfshije ndertimi, operimi ose mbyllja e vepimtarise dhe montimi i teknologjise dhe pajisjeve veprime qe te shkaktojne ndryshime fizike ne topografi, perdorim toke, ndryshime ne trupat ujore etj ?				
1.1	Ndryshime te perkoheshme ose te perhereshme ne pedorimin e tokes, mbulesen e saj ,topografin, duke perfshire ritjen e intensitetit te perdorimit te tokes	Po	Pjese te tokes ku ndodhet aktualisht porti Vlores	Jo (nuk do kete ndikim domethenes)
1.2	Pastrimin e tokes ekzistuese, vegjetacionit dhe ndertimeve ekzistuese?	Po	Thellim te basenit te portit te Vlores	Jo (nuk do kete ndikim domethenes)
1.3	Krijimin e perdorimeve te reja te tokes?	Jo		
1.4	Investigime para fazes ndertimore, si shpime per marrjen e mostrave, provat e tokes, dheut ?	Po	Pjese te tokes ku ndertohen veprat e Portit	Jo (nuk do kete ndikim domethenes)
1.5	Punime ndertimi?	Po	Ndertim i veprave te Portit	Jo (nuk do kete ndikim domethenes)
1.6	Punime prishjeje?	Jo		
1.7	Kantieri te perkoheshme per punime ndertimi ose strehimi per punetoret?	Po	Kantieri i ndertimit	Jo (nuk do kete ndikim domethenes pasi do te meren masa lehtesuese)
1.8	Punime mbitokesore, struktura ose punime te tokes, germime ose mbushje?	Po	Punime nentokesore dhe mbitokesore	Jo (nuk do kete ndikim domethenes)
1.9	Punime nentokesore, miniera ose tunele?	Jo		
1.10	Punime bonifikuese?	Jo		
1.11	Germime per hapje kanalesh?	Jo		
1.12	Struktura bregdetare, si diga, skela?	Po	Punime ne port per	Jo (nuk do kete ndikim)

			rehabilitim pontil, skoljera dhe kalata	domethenes)
1.13	Struktura ne det?	Po	Punime ne port per rehabilitim pontil, skoljera dhe kalata	Jo (nuk do kete ndikim domethenes pasi jane struktura ekz.)
1.14	Procese te ndryshme prodhimi?	Jo		
1.15	Mjedise per magazinim te mallrave e materialeve te ndryshme?	Po	Do te perdoren ambiente ekz dhe do te ndertohen te reja ne funksion te reabilitimit dhe shfrytezimit	Jo (do perdoren ambiente ekzistuese)
1.16	Impiante per trajnimin ose depozitim e mbetjeve te ngurta e te lengeshme?	Jo		
1.17	Objekte te strehimit punetoreve te shfrytezimit?	Jo		
1.18	Rruge e re, hekurudhe, trafik detar, gjate fazes se reabilitimit e shfrytezimit?	Po	Trafiku detar	Po (do kete ndikim domethenes pasi do te kete fluks me te larte mjetesesh lundruese)
1.19	Rruge e re, hekurudhe, ajrore, ujore, infrastruktura te tjera transporti, pefshire rruge e stacione te reja te alternuara porte e aeroporte?	Po	Porte	Po (do kete ndikim domethenes pasi do te kete fluks me te larte mjetesesh lundruese)
1.20	Mbyllje apo devijim i rrugeve ekzistuese qe te con ne ndryshime ne levizjet e trafikut?	Jo		
1.21	Linja ose tubacione te reja transferuese te transmetimit?	Jo		
1.22	Rezervuar, argjinatura,kanale nentokesore,regullime apo ndryshime te tjera ne hidrologjine e rrjedhave ujore apo akuifereve?	Jo		
1.23	Nderprerje te rrymave?	Jo		
1.24	Nxjerje ose transferim te ujit nga nentoka ose siperfaqet ujore?	Jo		
1.25	Ndryshime ne trupat ujore, siperfaqet e tokes qe ndikojne ne drenimin ose largimin e ujit?	Jo		
1.26	Transportin e personelit e materialeve te reabilitimit, shfrytezimit e mbeturinave?	Jo		
1.27	Punime afatgjate c'montimi, nxjerjen e mbeturinave ose punime restauruese?	Jo		
1.28	Veprimtari gjate ndryshimit te destinacionit qe mund te kene ndikim ne mjedis?	Jo		
1.29	Hyrjen e njerezve ne nje zone perkohesisht ose ne menyre te vazhdueshme?	Po	Levizja e puntoreve gjate ndertimit dhe njerezve gjate shfrytezimit	Jo (lidhet me aktivitetin ndertues)
1.30	Futjen per kultivim te specieve jovendase?	Po	Gjate fazes se shfrytezimit te portit	Jo (lidhet me aktivitetin shfrytezues te tij)
1.31	Humbjen e specieve vendase ose diversitet gjenetik?	Jo		
1.32	Ndonje veprim tjetër?	Jo		

2. A do perdoren gjate fazes se rehabilitimit dhe shfrytezimit te projektit burimet natyrore te tilla si: toka, uji, materiale e energji nga burime qe jane te parinovueshme ose te kufizuara?				
2.1	Toke vecanerisht e varfer apo toke bujqesore?	Jo		
2.2	Uji?	Jo		
2.3	Minerale?	Jo		
Pyetje qe duhet te mbahen parasysht gjate perzgjedhjes				
2.4	Grumbullime lendesh nderrimi (zhavor etj)	Po	Per prodhimin materialeve te ndertimit	Jo (rehabilitohet toka e perdorur per grumbullim inertesh pas perfundimit te punimeve)
2.5	Pyje dhe lende drusore	Jo		
2.6	Energji, elektrike apo lende djegese?	Po	Energji elektrike gjate ndertimit dhe shfrytezimit dhe lende djegese e anijeve gjate shfrytezimit	Jo (ldhet me aktivitetin shfrytezues te tij)
2.7	Ndonje burim tjetër?	Jo		
3. A do te perfshije projekti perdorimin, ruajtjen, transportin, perpunimin dhe prodhimin e substancave e materialeve qe mund te jene te demshem per shendetin e njerezve e mjedisin e risin shqetesimin mbi rreziqet aktuale e te mundshme ne shendetin e njerezve?				
3.1	A parashikon projekti perdorimin e substancave ose materialeve te rrezikshme ose toksike per njerzit dhe mjedisin?	Jo		
3.2	Do rezultojte projekti ne ndryshime me shfaqje semundiesh ose efekt ne vektoret e semundjeve	Jo		
3.3	Do ndikojte projekti ne mireqenien e njerezve ?	Po	Impakt pozitiv	Po (hapen vende pune dhe sherbim me te mire)
3.4	A ka grupe njerezish qe mund te ndikohen nga projekti, si te semure apo te moshuarit?	Jo		
3.5	Shkaqe te tjera?	Jo		
4. A do te prodhohen mbeturina te ngurta, gjate rehabilitimit, shfrytezimit ose uxjerje jashte funksioni?				
4.1	Mbeturina dherast zhavori ose minierash?	Po	Nga germimi per rehabilitimin e veprave hidroteknike dhe thellim baseni port.	Jo (do te transportohen materialet ne nje venddepozitim te aprovuar nga pushteti vendor)
4.2	Mbetje urbane (shtepiake ose tregetia) ?	Jo		
4.3	Mbetje te rrezikshme e toksike apo radioaktive?	Jo		
4.4	Mbetje te tjera te proceseve industriale?	Jo		
4.5	Produkte shtese?	Jo		
4.6	Ujra te zeza ose llumra te tjera nga trajtimet e shkarkimeve te lengeta?	Po	Ujra te zeza	Jo (nuk do te kete ndikim domethenes pasi do te shkarkohen ne kolektoret e qytetit)
4.7	Mbetjet nga ndertimet ose shembjet?	Po	Struktura betoni dhe celiku	Jo (do te transportohen materialet ne nje venddepozitim te aprovuar nga pushteti vendor)
4.8	Mbeturina makinash ose pajisjesh?	Jo		
Pyetje qe duhet te mbahen parasysht gjate perzgjedhjes				
4.9	Toka te ndotura ose materiale te tjera?	Jo		

4.10	Mbetje bujqesore?	Jo		
4.11	Mbetje te tjera te ngurta?	Jo		
5. A do te shkarkohen ndotes ne ajer ose cdo substance tjeter e rrezikshme toksike apo e demshme per shendetin nga projekti?				
5.1	Shkarkime nga djegiet e karburanteve nga burime stacionare ose te levizshme?	Po	Ndotja nga djegja e karburantit te kamjoneve, eskavatoreve, saldatrice, betoniereve, anijeve dhe trageteve	Po (ndikimi do te jete domethenes por gjate ndertimit dhe shfrytezimit te portit te perdoren mjete te testuara dhe certifikuara nga instancat kopetente per normat e lejuara te emetimit te gazrave ne ajer) p.sh. "SGS Albania"sh.p.k.
5.2	Shkarkime nga proceset prodhuese?	Jo		
5.3	Shkarkime nga perpunimi i materialeve, perfshi depozitimin ose transportin?	Po	Gjate shfrytezimit te portit mund te kete mallra qe transportohen apo depozitohen	Po (ndikime domethenese qe lidhen me aktivitetin e portit dhe do te zbatohen standartet per maretialet e demshme)
5.4	Shkarkime nga aktiviteti i rehabilitimit perfshi impiantet dhe pajisjet?	Po	Pluhur	Jo (nuk do te kete ndikim domethenes pasi do te behet sperkatje me uje)
5.5	Mbetje e erera sulmuese nga perpunimi i materialeve te rehabilitimit, ujrat e zeza e mbetjet?	Jo		
5.6	Shkarkime nga inceneratoret e plehrave?	Jo		
5.7	Shkarkime nga djegija e mbetjeve ne ajer?	Jo		
5.8	Shkarkime nga burime te tjera?	Po	Gjate shfrytezimit anijet qe ankorohen mund te derdhen ujrat e perdorur ose vajra	Po (ndikime domethenese qe lidhen me aktivitetin e portit dhe do te zbatohen rregullat strikte te planit te menaxhimit mjedisor)
6. A do te shkaktoje projekti zhurma dhe vibracione ose emetime te drites, energjise termike ose rrezatim elektromagnetik?				
6.1	Nga puna e paisjeve si: motora, franto,ventilus?	Po	Makinerite e ndertimit (sonda etj) dhe vincat gjate shfrytezimit .	Jo (nuk do te kete ndikim domethenes. Punimet e ndertimit kryhen ne orare te pershtatshme rreth 7.30-16.30)
6.2	Nga procese industriale apo te ngjajshme?	Jo		
6.3	Nga ndertime apo prishje?	Po	Nga ndertimi i portit	Jo (nuk do te kete ndikim domethenes. Punimet e ndertimit kryhen ne orare te pershtatshme rreth 7.30-16.30)
6.4	Nga plasje apo futje pilotash	Po	Vendosje pilotash dhe palankolash	Jo (nuk do te kete ndikim domethenes. Punimet e ndertimit kryhen ne orare te pershtatshme rreth 7.30-16.30)
6.5	Nga trafiku gjate rehabilitimit ose shfrytezimit?	Po	Nga shfrytezimi i portit	Po (do te vendosen regulla per mos lejimin e borive ne port)
6.6	Nga proceset e ndricimit ose ftohjes?	Jo		
6.7	Nga burimet e rrezatimit elektromagnetik (efektet mbi pajisjet dhe njerezit) ?	Jo		
6.8	Nga cdo burim tjeter?	Jo		

7. A do te coje projekti ne rreziqe te ndotjes se toke, ujit nga shkarkimet e ndotesave ne toke ne kanalizimet e ujrave te bardha dhe te zeza, ujrat sipërfaqesor, nentokesor, bregdetare ose ne det?				
7.1	Nga perpunimi, depozitimi, perdorimi ose shkarkim i lendeve te rezikshme e toksike?	Jo		
7.2	Nga shkarkimet e ujrave te zeza ose rrjedhjeve te tjera (trajtuara e patrajtuara) ne uje ose toke?	Jo		
7.3	Depozitimi ndotesve te shkarkuar ne ajer, uji toke	Jo		
7.4	Nga edo burim tjetër?	Jo		
7.5	A ka rrezik te ndonje akumulimi afatgjate te ndotesve ne mjedis nga keto burime?	Jo		
8. Ekziston rreziku i aksidenteve gjate rehabilitimit apo shfrytezimit te projektit qe mund te ndikojne ne shendetin e njerezve apo mjedisin?				
8.1	Shperthime, zjarre, nxjerje nga depozitimi, perdorimi e prodhimi i substancave te rezikshme e toksike?	Jo		
8.2	Nga ngjarje qe kaperejne kufijte e mbrojtjes normale te mjedisit, p sh. demtimi i sistemit te kontrollit te adotjes?	Jo		
8.3	Nga ndonje shkak tjetër?	Po	Gjate shfrytezimit mund qe anijet te derdhin mbetjet e tyre	Po (ndikime domethenese qe lidhen me aktivitetin e portit, te cilat nese ndodhin duhet te ndeshkohen sipas legjislacionit ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit)
8.4	Mund te ndikohet projekti nga fatkeqsi natyrore qe shkaktojne deme per mjedisin (permytje, termete, shkarje etj.)?	Jo		
9. A rezulton projekti me ndryshime sociale, ne demografi, menyre tradicionale jetese, punesim?				
9.1	Ndryshime ne madhesine e popullsisë, moshen, strukturen, grupet sociale etj.?	Jo		
9.2	Nga strehimi i njerezve apo prishja e shtepive, mjediseve te komunitetit, si shkolla, spitale, mjedise sociale?	Jo		
9.3	Nepermytjet migrimit te banoreve te rinj ose krijimit te komuniteteve te reja?	Jo		
9.4	Nga realizimi i kerkesave ne rritje per mjedise, sherbime sociale, strehim, arsim, shendet?	Jo		
9.5	Nga krijimi i vendeve te punes gjate rehabilitimit a shfrytezimit apo humbjes se vendeve te punes me pasoja ne papunesi e ekonomit?	Po	Nga ndertimit dhe shfrytezimit te portit	Po (Impakt pozitiv nga hapja e vendeve te punes)
9.6	Ndonje shkak tjetër?	Jo		
10. A do te coje projekti ne presion per zhvillime te metejshme qe mund te kene ndikim te rëndësishem ne mjedis, me shume banesa, rruge te reja, industri, veprimtari mbeshtetese				
10.1	A do te coje projekti ne presione per zhvillime te metejshme qe do te kete ndikim te caktuar ne mjedis, si: me shume strehim, rruge te reja, industri, sherbime publike mbeshtetese te reja?	Po	Nga shfrytezimi i portit	Po (do te kete ndikim domethenes me rritje aktiviteti te sherbimit dhe infrastrukures mbeshtetese etj)
10.2	A do te coje projekti ne zhvillimin e mjediseve mbeshtetese, zhvillime ndihmese ose zhvillime te uxitura nga projekti qe te kete ndikim mjedisi, si: 1. infrastrukture mbeshtetese (rruge, furnizim me energji elektrike, trajtim te mbetjeve ose ujrave te perdorura etj.) 2. Zhvillim i strehimit; 3. Industri nxjeresese (ekstraktuese); 4. Industri furnizuese; 5. te tjera	Po Jo Jo Jo Jo	Infrastrukture mbeshtetese	Po (do te kete ndikim domethenes me rritje infrastrukures mbeshtetese si rruge, linja transporti, etj)

10.3	A do te coje projekti ne riperdorim te kantjerit pas shfrytezimit te tij qe do te kete ndikim ne mjedis?	Jo		
10.4	A do te coje projekti ne krijimin e nje precedenti per zhvillime te mevoneshme?	Po	Nga shfrytezimi i portit	Po (do te kete ndikim domethenes pasi do te ndertohet sherbime ne funksion te portit)
10.5	Do kete projekti pasoja kumulative nga afersia me projekte te tjera ekzistuese ose te planifikuara e me pasoja te ngjashme?	Po	Nga ndertimi i portit	Po (Per ndertim te objekteve te banimit, turizmit dhe sherbimeve)

7. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE DHE VLERESIMI I SITUATES

7.1 Ndikimet e mundshme ne mjedis gjate fazes se operimit te portit te Vlores

Ne fazen se shfrytezimit te portit ndikim te mundshem ne mjedis mund te kete ancorimi i anijeve te vjetra te cilat emetojne gazra ne ajer mbi normat e lejuara. Gjithashtu problem i viteve te fundit ka qene derdhja e mbeturinave ose e ujit te perdorur nga anijet qe kalojne tranzit ne ujerat tona teritoriale ose ato qe ancorohen ne port. Me problematike do te jene rastet e derdhjes se vajrave ose karburanteve ne ujrata tona te cilat demtojne gjallesat dhe ujin e detit duke shkaktuar edhe pasoja ne aktivitetin jetik dhe ekonomik te bregdetit. Te gjitha keto mundesi lidhen me masat qe meren nga administruesit e portit ne te tilla raste te cilet duhet te hartojne planin e menaxhimit mjedisor per fazen e shfrytezimit dhe te kene regullore te forta per tu zbatuar nga anijet dhe tragetet qe perpunohen ne port.

7.2 Ndikimet ne mjedis gjate rehabilitimit te portit.

Per rehabilitimin e ketij porti do te ndertohen keto vepra: do te thellohet porti dhe dherat qe dalin do te depozitohen ne vendin e percaktuar ne toke nga pushteti vendor, do te ndertohen pilota dhe vendosen palankola, do te ndertohen struktura betoni te derdhura ne vend dhe parafabrikat, etj. Pra gjate kryerjes se ketyre operacioneve do te kete krijim te pluhurave si rezultat i punimeve te ndryshme qe duhen bere per realizimin e objektit te cilat do te zbuten me sperkatjen me uje te kantjerit ne menyre periodike sipas planit te organizimit te punimeve.

7.3 Ndikimet ne mjedis gjate largimit te materialeve qe do te krijohen nga punimet, etj

Terreni i ceket qe karakterizon detin Adriatik, tregon se kemi te bejme me shume germime rreth 144 000m³ per thellimin e basenit te perpunimit te mjeteve. Materialeve e germimit eshte e nevojshme te largohen me mjete nga toka per shkak se depozitimi i tyre ne det do te turbullone ujin e detit dhe mund te permbajne grimca te renda nga shfrytezimi disavjecar i tij, te cilat nuk duhet te perhapen ne det nga dallget dhe mund te prishin ekulibrat natyrore. Per te shmangur situata te cilat mund te ndikojne ne mjedis ato do te depozitohen ne toke ne vende te caktuara per depozitimin e mbetjeve te ngurta. Pikerisht pushteti lokal duhet te caktojte vendin e pershtatshem ku do te depozitohen pa shkakuar ndotje te tjera ne mjedis.

7.4 Ndikimet ne mjedis si rezultat i sjelljes se inerteve per rehabilitimin e veprave.

Megjthese kemi te bejme me ndertime te permasave te medha (kalata me gjatesi mbi 470 ml dhe thellesia max 7.72m), do te kemi volume te konsiderueshme materialesh. Per prodhimin e betonit do te nevoiten inerte (rere, cakull, beton, tuba, etj.) qe do te sillen nepermjet makinave te tonazhit te larte dhe te mesem. Keto materiale do te krijojne plihur dhe balte ne rruge per kete do te meren masa per shplarjen e mjeteve sa here dalin nga kantjeri.

7.5 Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese

Realizimi i objektiveve dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt, do te varet nga respektimi i treguesve te percaktuar. Kontrolli i monitorimit dhe permiresimi i vazhdueshem, sipas kushteve te shfrytezimit te krijuar pas rikonstruksionit, do te çojë perfundimisht ne perfitimin e pamjeve te shume deshuruara nga perdoruesit dhe banoret e zones.

7.6 Zhurmat

Gjate rehabilitimit te portit, do te kete angazhim te makinerive per punime germimi, transporti materialesh, etj. Per te zbutur efektin e trafikut te ngarkuar dhe zhurmave qe shoqerojne ate, me qellim uljen e shqetesimeve per popullaten perreth zones, si rruge te do te perdoren ku te jete e mundur ato dytesore. Transportimi i materialeve te rehabilitimit do te programohet me kujdes per te shmangur cdo shqetesim ne trafikun lokal. Gjate nates, automjetet do te kerkohet qe te operojne me shpejtesi te ulta dhe do te ndalohet perdorimi i borive.

7.7 Ndikimet ne det

Zbatimi i ketij projekti nuk le shkas per ndotjen e ujerave detare nga ndotes te ndryshem si karburantet, lendet helmuese etj. Nuk pritet te ndodhe qofte dhe ndonje ndotje indirekte qe mund te rezultojne nga shkarkimet ne det, e me pas te shperndahet nga dallget, pasi ato nuk do te perdoren gjate zbatimit te projektit apo rehabilitimit te territorit, ndersa nga karburantet mund te kete vetem ndotje aksidentale nga rrjedhja e mjeteve te punes.

8. PLANI I ZBUTJES SE NDIKIMEVE NEGATIVE

8.1 Perdorimi tokes

Ndertimi i veprave hidroteknike te portit, nuk krijon shqetesim per komunitetin perreth, si gjate fazes se rehabilitimit ashtu dhe ne fazen e shfrytezimit. Punimet e rehabilitimit do te vazhdojne per nje periudhe te vogel kohe dhe nuk do te krijojen demtime domethenese te tokes. Nuk ka mbetje demtuese ne siperfaqen ku do te ndertohen kalatat.

Per sa i perket rehabilitimit te portit, ai shtrihet mbi siperfaqen ekzistuese te portit. Kalatat, Skolierat dhe Pontileve nuk do te zene toke te re po do te zgjerohen ne drejtim te basenit te portit. Duhet te theksojme edhe njehere se te gjithë nenobjektet e portit nuk vendosen ne toke buke, por ne breg te detit, ne teritorin aktual te portit.

8.2 Ndikimi tek njerezit, ndertesat dhe objektet e ndertuara nga njeriu

8.2.1 Ndikimi ne popullsi

Rehabilitimi i portit, ne kete zone nuk ka per te sjelle probleme per komunitetin e kesaj zone. Realizimi i ketij projekti, duke mos patur nevojte per zgjerimin e tij, nuk do te shkaktoje ndryshime ne populltesi te saj, apo zhvendosje te saj per shkak te ketij aktiviteti.

Nderkohe duhet te theksojme qe ndertimi i portit, do te kete avantazhe te medha, jo vetem per biznesin, por dhe per turizmin e kesaj zone. Planet ne perspektive per shtrirjen qe do te kete zona ne nje te ardhme te afert, kjo e bazuar dhe ne studimin urbanistik zonal te miratuar, si dhe vete situata e veshitire e transportit detar qe po kalon vendi yne e rajoni ne pergjithesi, flasin per domosdoshmerine e fillimit sa me shpejt te ketij projekti. Nderkohe duhet theksuar dhe fakti qe ne kete aktivitet mendohen te punesohen nje numer i konsiderueshem punonjesisht duke zbutur sado pak plagen e papunesise dhe ate te emigracionit.

8.2.2 Ndikimet ne paisazh

Kemi theksuar se karakteristike e portit, eshte rruajtja dhe mos ndryshimi i paisazhit dhe mjedisit turistik te saj, prandaj paisazhi nuk ka per te patur asnje demtim dhe nuk do te kete nevojte per rigjenerim per periudhen e shfrytezimit te portit.

8.3 Ndikimet e portit mbi trashgimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe vepra te tjera njerezore

Si rezultat i rehabilitimit te portit ne kete zone, nuk ka dhe nuk do te kete ndikime negative mbi trashgimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerezore, sepse ne zone dhe perreth saj, nuk ka objekte te nje rendesie te vecante te karaktereve te mesiperme.

8.4 Ulja e intensitetit te erozionit dhe zbutja e ndryshimeve te topografise

Qellimi i projektit lidhet me rehabilitimin e portit, per rritjen e perpunimit te mallrave dhe pasagjereve. Nder objektivat themelore te ketij aktiviteti eshte perpunimi i sa me shume anijeve dhe trageteve nderkohe qe kushtet aktuale krijne shume probleme ne Shqiperi edhe ne rajon. Nuk do te kete erozion dhe ndryshimet e topografise do te jene minimale per shkak te baticave dhe zbaticave te detit qe ne periudha te caktuara kohore kerkojne pastrim te basenit te portit.

9. NDIKIMET NE FLORE, FAUNE

9.1 Bimet e ujit

Ne zonen ku shtrihet porti ekzistues nuk ka bime uji, per vete morfologjine qe ka deti, dhe per karakterin abraziv te tij ne zonen ku do te behen nderhyrje. Nga ky aktivitet nuk do te kete demtime te tyre.

9.2 Flora dhe Fauna

Zona sic eshte pershkuar edhe me lart, nuk eshte e mbushur me bimesi, pasi porti eshte ekzistues dhe do te ridimensionohen e per pasoje nuk demtojne asgje. Fauna e zones, sidomos ajo ujore, nuk peson ndonje ndryshim te ndjeshem nga ky projekt. Pjesa e detit mbas rehabilitimit te portit, konsiderohet e mbushur me peshq. Aktiviteti i rehabilitimit e shfrytezimit nuk sjell influence negative ne folenizim, shumezim, etj. Gjate fazes se shfrytezimit nuk ka elemente te shqetesimit per demtimin e faunes. Po ashtu edhe fauna karakteristike e zones eshte e paprekshme nga ndikimet e rehabilitimit te ketyre veprave, per arsye se aktiviteti i rehabilitimit dhe shfrytezimit nuk demton as ne lloje e as ne numer elementet e flores dhe faunes, si pjese perberese e ketij rajoni. Pra, si perfundim theksojme se ndertimi i portit, dhe shfrytezimi i tij nuk e demton floren dhe faunen e kesaj zone.

10. NDIKIMET E PRITSHME NE MJEDISIN PERRETH

10.1 Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise se zones, tokes, etj.

Gjate te rehabilitimit te portit, dhe te projekteve perkatese, do te kete ndryshime pothuajse te paperfillshme te topografise lokale. Ne projektet e tij jane parashkuar nje radhe nderhyrjesh qe, ne kombinim me masat e tjera suplementare te sistemimit dhe trajtimit, parandalojne erozionin e mundeshem. Ne projekt eshte parashikuar nje radhe pune dhe drejtim i tille, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, te parandalojne fenomenin e erozionit:

- Ndikimet ne perdorimin e tokes dhe te burimeve
- Ne cilesine dhe sasine e tokes plazh

10.5 Ndikimet e ndotesve dhe mbetjeve ne cilesine e ujit

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti nuk do te kete ndikim ne cilesine e ujit, si gjate ndertimit dhe gjate shfrytezimit.

10.6 Ndikimet ne ajer

Ushtrimi i ketij aktiviteti nuk ka ndikim ne cilesine e ajrit te zones, mbasi gjate shfrytezimit nuk do te kete emetime te gazrave dhe pluhurave.

10.7 Ndikimi ne klime

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti nuk ka ndikim ne klimen e kesaj zone.

10.8 Aromat sulmuese

Gjate ushtrimit te ketij aktivitetj nuk ka emetime te aromave te ndryshme te cdo lloji qofshin ato.

10.9 Ndikime te tjera klimatike

Gjate ushtrimit te ketij aktiviteti nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj.

10.10 Ndikime te tjera indirekte dhe sekondare qe shoqerojne projektin

Projektet e tjera si p.sh. rruget e reja, kanalet e ujrave te zeza, fjetinat dhe mencent, linjat e energjise, telekomunikacioni, etj. nuk do te ndikojne ne realizimin e ketij projekti, pasi ne zonen qe prek ky projekt nuk ka elemente te infrastruktures sic u permenden me lart pervec atyre per nevoja vetjake.

10.11 Ndikimet shoqeruese te projektit me projekte te tjera ekzistuese ose te propozuara

